

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni penal,** Gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Mihrie Krasniqi-Sheholli dhe bashkëpunëtoren profesionale Valbonë Fejza, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.K. me vendbanim në fshatin K., Komuna e P. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1499/16 të dt.22.02.2018, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur më dt.24.10.2018 në praninë e Prokurores së Shtetit – Ajshe Ferati, të dëmtuarit B.Sh. dhe të akuzuarit, të njejtën ditë në prezencë të palëve, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 19.11.2018 përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

### I akuzuari,

**N.K.** nga i ati A. dhe nëna H., e vajzërisë J., i lindur më datë *data e lindjes...*, në fshatin K., Komuna e P. ku edhe tani jeton, me numër personal të identifikimit: *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion-bujk, i gjendjes së mesme ekonomike-financiare, i pa martuar, sipas evidencës penale të kësaj gjykate i njejtë ka qenë i gjykuar edhe më parë, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar – Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

## Ë S H T Ë F A J T O R

### S e p s e :

Me dt.06.08.2015 rreth orës 19:00 në fshatin M., Komuna e P. i pandehuri N.K. pas një fjalosje me të dëmtuarin B.Sh., e ka sulmuar me gurë si mjet i rrezikshëm për shkaktimin e lëndimeve trupore me ç'rast i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, në formë të enjteve, ndrydhjes dhe gjakderdhjes nënlekurore në regjionin e nyjeve talok rurale,-

-Me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 73 dhe 188 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 366, 369, 370, 450, 453, 463, të KPPRK-së, e:

## **G J Y K O N**

Me dënim me gjobë, ashtu që të akuzuarit N.K., i shqipton dënim në shumën prej 300 (treqind/euro), të cilin dënim duhet ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë, brenda afatit prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 (njëzet) euro do t'i llogaritet 1 (një) ditë burgim.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale-të shpenzimeve paushallit gjyqësor shumën prej 50€euro (pesëdhjetë/euro), kurse në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€euro (tridhjetë/euro) të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

I dëmtuari B.Sh. nga fshati M., Komuna e P. ka hequr dorë nga kërkesa pasurore-juridike.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën me kërkesën për dhënien e Urdhërit Ndëshkimor, PP.II.nr.1499/16 të dt.22.02.2018 kundër të akuzuarit N.K. me vendbanim në fshatin K., Komuna e P. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.4 të KPRK-së.

Gjykata e ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë për shqiptimin e Urdhërit Ndëshkimor dhe ka lëshuar Aktgjykim-Urdhër Ndëshkimor, me shenjën P.nr.166/2018 të datës 10.04.2018, kundër të cilit brenda afatit ligjor i akuzuari ka parashtruar kundërshtim.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor më dt.24.10.2018 gjatë së prezantuan Prokurorja e Shtetit Ajshe Ferati nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, i dëmtuari B.Sh. dhe i akuzuari.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se bëj cilësimin dhe rikualifikimin e veprës penale ashtu që duhet të jetë “Me dt.06.08.2015 rreth orës 19:00 në fshatin M., Komuna e P. i pandehuri N.K. pas një fjalosje me të dëmtuarin B.Sh. e ka sulmuar me gurë si mjet i rrezikshëm për shkaktimin e lëndimeve trupore me ç’rast i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, në formë të enjteve, ndrydhjes dhe gjakderdhjes nënlëkurore në regjionin e nyjeve talokrurale, -me këtë ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së. Shkaku pse është bërë ricilësimi dhe rikualifikimi i veprës penale është se gjendja faktike u vërtetua me deklaratën e të dëmtuarit i cili në mënyrë të qartë vërtetoi se i pandehuri ditën kritike e ka gjuajtur me gurë e jo me grushta, gjithashtu dhe duke u bazuar në mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko-ligjor i cili në mënyrë të qartë i ka konstatuar lëndimet

trupore të dëmtuarit, andaj mbetem në tërësi pranë aktakuzës dhe ricilësimit të sotëm dhe kërkoj nga gjykata që të njejtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

I dëmtuari B.Sh. në fjalën përfundimtare deklaroi se nuk parashtroj kërkesë pasurore-juridike.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se nuk e ndjei veten fajtor, kërkoj nga gjykata që të më shpall të pafajshëm dhe të më liroj nga kjo aktakuzë.

Gjykata gjatë procedurës së provave ka dëgjuar dëshmitarin-të dëmtuarin B.Sh. si dhe ka lexuar: Mendimin e ekspertit mjeko-ligjor me numër reference Pr-378 të datës 20.06.2016 si dhe deklaratat e palëve në shkresat e lëndës.

I akuzuari i ka propozuar gjykatës që në cilësi të dëshmitarit ta ftoj V.(M.) K. nga fshati K. të cilin e ka djali të axhës i cili propozim u kundërshtua nga prokurorja e shtetit me arsyetimin se pasi dëshmitari i propozuar është djali i axhës të akuzuarit do të dëshmoj në favor të tij dhe se në kohën kur ka ndodhur ngjarja i njejtin ka qenë i mitur.

Gjykata me aktvendim ka refuzuar propozimin e të akuzuarit që në cilësi të dëshmitarit të dëgjohet djali i axhës së tij V.K. për shkak se i njejtin është në afërsi gjaku me të pandehurin dhe se dëshmia e tij sipas vlerësimit të gjykatës nuk do të jetë e besueshme për shkak se do të jetë e njëanshme duke pasur parasysht afërsinë me të pandehurin.

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje, gjykata konform nenit 8 dhe nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartcekura që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërgjegje i ka vlerësuar çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerrë përfundim lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Kjo gjykatë konsideron se përtej çdo dyshimi pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

I dëmtuari-dëshmitari B.Sh. në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash ka deklaruar se: Unë e njoh N. sepse unë jam i M. e ky është i K., kam marrë disa livadhe me qira nga Sh.Sh. në fshatin mes M. dhe K. me të cilin nuk kemi përpiluar kontratë por vetëm marrëveshje gojore dhe kam paguar 250 deri 300 Euro në vit. Ditën kritike kam qenë duke i ruajtur bagëtitë në livadhin të cilin e kam pasur me qira kurse N. i ka pasur bagëtinë në një livadh tjetër të cilin e kam pasur me qira nga E.M. të cilin e kam djali të mixhës, kam shkuar te N. dhe i kam thënë pse po më bën zarar për shkak se nonstop mi ka kullot livadhet pasi që janë kositur dhe më ka shkaktuar dëm nonstop dhe duke biseduar jemi shtyrë, pas një mosmarrëveshje më ka ra dhe ndoshta i kam ra pak duke u shtyrë, ai u largua dhe pas 20 minutave i kishte marrë disa gurë të mëdhenjë dhe më ka ra me gurë në këmbë, pastaj jam larguar nga vendi i ngjarjes dhe kam shkuar te bagëtia ime ku i pandehuri ka ardhur, më ka sharë, mu ka kërcënuar, më ka gjuajtur me gurë dhe ma ka lënduar këmbën e djathtë për çka edhe kam shkuar te mjeku, gjatë përleshjes kanë qenë prezent disa fëmijë të vegjël, rastin e kam lajmëru në polici të nesërmen sepse nuk kam ditur, nuk jam provuar me këto sende, gjithashtu edhe te mjeku kam shkuar të nesërmen për shkak se ka qenë vonë, kam pasur dhimbje por kam duruar meqë kurrë nuk kam pasur, ka 3 vite që më nuk i punoj ato livadhe.

Nga Raporti i ekspertit mjeko-ligjor me numër reference Pr-378 të datës 20.06.2016, vërtetohen lëndimet për të dëmtuarin B.Sh. të cilat janë paraqitur në formë të enjtes, ndrydhjes dhe gjakmbledhjes nënlekturore në regjionin e nyjeve talok rurale dhe janë të shkaktuara si rezultat i veprimit mekanik të mjetit të fortë, mbretës (jo të mprehtë) dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet.

I akuzuari N.K. në shqyrtimin gjyqësor veç të tjerash ka deklaruar se me dt.06.03.2015 kam qenë në tokën time private me djalin e mixhës së babës dhe B. ka ardhur dhe më ka goditur fare pa diskutuar, nuk e kam njohur dhe për herë të parë e kam parë atë ditë, pastaj unë me djalin e mixhës kemi shkuar në shtëpi dhe nuk kam dashur që ta bëj të madhe këtë punë, nuk i kam treguar as familjes dhe nuk është e vërtetë që unë kam marrë një guri të madh dhe e kam rrokur B. sepse nuk ka logjikë që nga 15 metra largësi ta gjuaj B. me gurë. Ditën kritike B. më ka goditur me boks në fytyrë 5-6 herë dhe unë duke e respektuar si prind nuk kam ndërmarrë asgjë, kam shkuar në shtëpi, jam skuqur në fytyrë por familjarët nuk më vërejtën.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të provave, vërtetoi gjendjen faktike nga dëgjimi i të dëmtuarit-dëshmitarit B.Sh. i cili bindshëm ka deklaruar se i akuzuari N.K. e ka gjuajtur me gurë në këmbën e djathtë, kjo gjendje faktike vërtetohet edhe nga Raporti i ekspertit mjeko-ligjor me numër reference Pr-378 të datës 20.06.2016 me të cilin janë konstatuar dëmtimet e lehta trupore për të dëmtuarin si dhe nga deklarata e të dëmtuarit dhe me të gjitha këto prova vërtetohet pa mëdyshje gjendja e plotë dhe e drejtë faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të cilave gjykata j'ua fali besimin nga se ndërliiden me njëra tjetrën.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së, për të cilën veprë penale gjykata edhe e shpalli fajtor dhe e dënoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mbrojtjen e të akuzuarit, gjykata e ka vlerësuar duke e hedhur poshtë si të pa bazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara dhe një përpjeke e të akuzuarit për t'iu shmangur përgjegjësisë penale.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarve, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe masën e dënimit të parapara me nenin 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjykata nuk gjeti ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti faktin se i njëjti ka qenë i gjykuar edhe më parë nga kjo gjykatë për vepra tjera penale, prandaj ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit dhe ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi zëvendësimin e dënimit me burgim në dënim me gjobë është marr në kuptim të nenit 46 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u marr në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 dhe 3 të KPPRK-së dhe vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marrë, konform nenit 39 par.3 nënpar 3.1 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË,**  
**Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal**  
**P.nr.166/18 me dt.09.11.2018**

**Zyrtare Ligjore**  
**Mihrie Krasniqi-Sheholli**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Gazmend Bahtiri**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.